



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr 2138/Prot

Tiranë, më 02.09.2019

THIRRJE PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR
KANDIDATË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

Me shkresën nr. 637 prot., datë 02.08.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm është njoftuar se ky këshill, me vendimin e tij nr. 161, datë 02.08.2019, ka vendosur: Të deklarojë mbarimin e mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë të z. Gentjan Osmani për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës. Ky vendim ka qenë rezultat i vendimit të Kolegjit të Posacëm të Apelit nr.20, dt.31.07.2019, me të cilin është vendosur ndryshimi i Vendimit nr. 61, datë 02.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra si prokuror, të Subjektit të Rivlerësimit z. Gentjan Osmani.

Z. Gentjan Osmani ka ushtruar funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i zgjedhur nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Shkallës së Parë.

Në këto kushte, me qëllim plotësimin e vendit të mbetur vakant, deri në mbarimin e mandatit të anëtarit të larguar, bazuar në nenin 149/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, **ftojmë prokurorët e interesuar nga Prokuroritë e Shkallës së Parë**, që plotësojnë kriteret sipas ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të sjellin kërkesën për shprehjen e interesit, si dhe dokumentet e kërkuara, pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Të interesuarit, krahas kërkesës me shkrim, të bashkëngjisin dhe dokumentet e mëposhtme:

- a) jetëshkrimin e përditësuar;
- b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkruara rregullisht;
- c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;
- d) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;
- dh) një deklaratë individuale të nënshkruar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- e) informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor.
- ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- g) Formularin e Autoritetit për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Paraqitja e shprehjes së interesit duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së thirrjes, në adresën elektronike zyrtare Enkeleida.Zotkaj@pp.gov.al ose të dorëzohet personalisht në institucion apo nëpërmjet postës, në adresë të Prokurorit të Përgjithshëm.

Kjo thirrje u dërgohet të gjithë prokurorëve në adresën elektronike zyrtare.

U shpall sot më datë 02.09.2019.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Arta MARKU

